

## 1. Regjistrimi i Ofruesve të Shërbimeve Postare sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare

Bazuar në:

- Ligjin nr. 46/2015, datë 7.5.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe
- Rregulloren nr. 38, datë 19.11.2015 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”

Subjektet që kërkojnë të ofrojnë shërbime postare në Republikën e Shqipërisë, kryejnë njoftim në modulën e aplikimeve *online* të AKEP (duke plotësuar formularin *online* dhe duke bashkëngjitur dokumentet përkatës të kërkuara sipas rregullores nr.38) dhe regjistrohen në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare. AKEP i pajis këta subjekte me certifikatën e konfirmimit të njoftimit, në të cilën shënohen zonat e ofrimit të shërbimit si dhe llojet e shërbimeve që do të kryejë ofruesi i shërbimeve postare.

Dokumenti i lëshuar nga AKEP në këtë rast është Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit ofruesit të shërbimeve postare, dhe ky dokument nuk ka afat vlefshmërie.

Për regjistrimin si ofrues në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare subjektet nuk paguajnë, por në zbatim të ligjit 46/2015 ofruesit e shërbimit postar janë të detyruar të paguajnë në AKEP një pagesë vjetore për të mbuluar kostot administrative përkatëse të AKEP-it për mbikëqyrjen e tregut postar. Kjo pagesë nuk është më shumë se 0.5% e të ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm, të siguruara vetëm nga shërbimet postare.

## 2. Autorizimet Individuale për përdorime numeracionesh

Bazuar në:

- Ligjin 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*;
- Rregullore nr. 10, datë 11.8.2009 “Për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.932, datë 11.08.2009, *e ndryshuar*.
- Rregullore nr. 17, datë 16.4.2010 "Për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtarë (NSPC) dhe Ndërkombëtarë (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.

Procedura e aplikimit për caktim ose anulim numeracioni, bëhet në sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi i cili kërkon të pajiset me numeracion ose të anulojë numeracionin e caktuar më parë nga AKEP.

Dokumenti i lëshuar nga AKEP për këtë shërbim, bazuar në Rregulloren nr.10 dhe nr.17 është Njoftimi për caktim dhe përdorim numeracioni, i cili shoqërohet nga Aneksi/et përkatëse të përcaktuara në Rregulloren nr.10. Ky dokument nuk ka afat vlefshmërie.

Pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike si dhe kodeve NSPC, ISPC përcaktohen sipas VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike” i ndryshuar.

### 3. Autorizim për përdorimin e Stacionit Radiobregdetar

Në zbatim të:

- Rregullores nr. 5, datë 23.12.2008, “Për dhënien e Autorizimit për Stacionet Radiobregdetare”

Subjektet të cilët kërkojnë të instalojnë Stacione Radiobregdetare dhe nëpërmjet tyre të bëjnë të mundur ofrimin e shërbimit për stacionet radio të anijeve, janë të detyruar të pajisen me autorizim të posaçëm për instalimin dhe përdorimin e stacionit radiobregdetar. Procedura e aplikimit për autorizimin radiobregdetar bëhet në sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi i cili kërkon të pajiset me këtë dokument. Dokumenti i lëshuar nga AKEP për këtë shërbim është “Autorizim për përdorimin e stacionit radio bregdetar”. Autorizimi i lëshuar sipas kësaj rregulloreje është i vlefshëm për një periudhë 5 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Pagesa për pajisjen me Autorizim për përdorimin e stacionit radiobregdetar përcaktohen sipas VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit".

### 4. Certifikatë aftësie e Operatorit Radiodetar GMDSS

Në zbatim të:

- Rregullores nr.6, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Certifikatës Operatorit Radiodetar”.

Përdoruesi i stacionit radioanije dhe stacionit radiobregdetar, duhet të pajiset me Certifikatën e Operatorit Radiodetar nga AKEP. Procedura e aplikimit për pajisje me Certifikatën e Operatorit Radiodetar bëhet në sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi. Certifikata e operatorit radiodetar është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë rinovimi.

Pagesa për pajisjen me Certifikatën e Operatorit Radiodetar përcaktohen sipas VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit".

### 5. Licencë për përdorimin e stacionit radio të anijes

Në zbatim të:

- Rregullores nr.7, datë 23.12.2008 ”Për dhënien e Licencës për Stacionet Radio të Anijes”, ndryshuar.

Mjetet e lundrimit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të instaluar në bord pajisje radiokomunikimi duhet të pajisen me Licencë për përdorimin e stacionit radio të anijes. Procedura e aplikimit për pajisje me Licencë për përdorimin e stacionit radio të anijes bëhet në

sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi. Licenca e lëshuar sipas kësaj rregulloreje është e vlefshme për një periudhë 5 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë rinovimi. Pagesa për pajisjen me Licencë për përdorimin e stacionit radio të anijes përcaktohen sipas VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike” i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit".

## 6. Licencë për përdorimin e stacionit radio të avionit

Në zbatim të:

- Rregullores për dhënien e Licencës “Për Stacionet Radio të Avionit”, ndryshuar.

Subjekti që kërkon të pajiset me licencë për përdorimin e stacioneve radio të avionit duhet të aplikojë *online* sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, i cili shoqërohet me tabelën mbi të dhënat teknike dhe deklaratën e pronarit/personit. Procedura e aplikimit për pajisje me licencë për përdorimin e stacioneve radio të avionit bëhet në sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi. Licenca e lëshuar nga AKEP sipas kësaj rregulloreje është e vlefshme për një periudhë 5 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë rinovimi. Pagesa për pajisjen me Licencë për përdorimin e stacioneve radio të avionit përcaktohen sipas VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit".

## 7. Licencë për shërbime radioamatore në Republikën e Shqipërisë

Në zbatim të:

- Rregullores për “Shërbimet Radioamatore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar.

Kjo rregullore zbatohet ndaj personave fizikë, shoqatave dhe institucioneve të formimit profesional që zhvillojnë aktivitet radioamator në Republikën e Shqipërisë. Procedura e aplikimit për pajisje me licencë për shërbime radioamatore bëhet në sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi. Periudha e vlefshmërisë së licencës individuale të amatorit është:

- në rastin e licencës së nivelit “*beginner*” 4 vjet, nëse aplikanti është më i vogël se 18 vjeç,
- 5 vjet, nëse aplikanti është mbi 65 vjeç;
- 5 vjet, në rastin e licencës të klasës CEPT Novice;
- 5 vjet, në rastin e licencës të klasës CEPT;
- Licencat e amatorit për grupin janë të vlefshme për 5 vjet, por nuk mund të kalojnë vlefshmërinë e licencës individuale të instruktorit amator.

- Licencat speciale të amatorit janë të vlefshme, për jo më shumë se 5 vjet (me përjashtim të stacioneve që përdoren për raste të veçanta), por nuk mund të kalojnë vlefshmërinë e licencës individuale të instruktorit amator.
- Në rastin e stacioneve që përdoren për raste të veçanta, periudha e vlefshmërisë do të jetë sa periudha e zgjatjes së aktivitetit, por në asnjë rast nuk mund të kalojë një vit dhe as periudhën e vlefshmërisë së licencës individuale të instruktorit amator.
- Për radioamatorët e huaj afati i vlefshmërisë nuk mund të kalojë periudhën prej 6 muajsh.

Pagesa për pajisjen me Licencë për shërbime radioamatore përcaktohet sipas Udhëzimit nr.28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit".

#### 8. Licencë për ushtrimin e veprimtarisë “Autoritet i Llogarive Detare” dhe pajisjen me kodin AAIC

Në zbatim të:

- Rregullores nr.14, datë 13.4.2010, “Për dhënien e licencës “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC”, ndryshuar.

Subjektet që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, pajisen me licencë bazuar në momentin e regjistrimit të kërkesës së tyre në AKEP. Procedura e aplikimit për pajisje me licencë “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC” bëhet në sistemin *online* të AKEP nga vetë aplikuesi. Afati i vlefshmërisë së licencës ALD dhe kodit AAIC është 3 vjet, me të drejtë rinovimi në përputhje me kushtet dhe rregullat në fuqi në momentin e rinovimit të saj.

Pagesa për pajisjen me Licencë “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC” përcaktohen sipas VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike” i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit".

#### 9. Regjistrimi i pajisjeve radio në regjistrin e pajisjeve radio

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmoniozuara”.
- Rregulloren nr. 48, datë 22.4.2020 “Për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”

Pajisjet radio të mbuluara nga Rregulli Teknik, miratuar me VKM nr.378, datë 5.6.2019, mund të vendosen në treg dhe në shërbim, vetëm nëse janë në përputhje me Rregullin Teknik dhe nëse janë instaluar sipas specifikimeve përkatëse si dhe mirëmbahen dhe përdoren për qëllimin e synuar. Prodhuesit duhet të regjistrojnë në AKEP tipet e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, të VKM nr. 378, në një regjistër të siguruar nga AKEP, përpara se ato kategori të vendosen në treg. Njoftimi për regjistrimin e tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore, paraqitet me shkrim në AKEP, ose në formë elektronike në sistemin *online* të AKEP, sipas Formularit të Njoftimit, Aneks 1 të rregullores shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm. Dokumenti i lëshuar nga AKEP është Konfirmim Regjistrimi. Ky dokument nuk ka afat vlefshmërie. Pagesat për regjistrimin e tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### 10. Regjistrimi i pajisjeve radio të brezave 2.4 / 5.8 GHz

Në zbatim të:

- Rregullore nr. 33, datë 15.5.2014 “Për kushtet për përdorimin e frekuencave që përdoren pa autorizim individual si dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdorin këto frekuenca”
- Rregullat mbi regjistrimin dhe përdorimin e frekuencave të brezit 2.4/5.8 GHz

Përdoruesit e pajisjeve radio transmetuese të miratuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9918, i ndryshuar, dhe që përdoren vetëm në frekuencat “kolektive”, të përcaktuara në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje, nuk kanë nevojë për autorizim individual. Për këto pajisje është e detyrueshme që të vihen në punë vetëm mbas raportimit në AKEP, dhe që bëhet nëpërmjet një procedure në sistemin *online*. Regjistrimi pranë AKEP duhet të kryhet minimumi 30 ditë para fillimit të përdorimit të tyre, dhe jo më shumë se 90 ditë më parë.

#### 11. Domain ccTLD.al

Regjistrimi i një emër domaini “.al” në AKEP kryhet duke plotësuar formularin e aplikimit, i cili, pasi plotësohet, mund të dorëzohet pranë zyrës së Protokoll/Arkivës në AKEP ose dërgohet i skanuar me *e-mail* në adresën elektronike [domain@akep.al](mailto:domain@akep.al).

Pagesa e regjistrimit të një emër domaini pranë AKEP është 5000 (pesë mijë) lekë për 5 (pesë) vjet.

#### 12. Procedura e pajisjes me Autorizim Individual

Bazuar në:

1- Nenin 67 “Procedura e dhënies së autorizimit individual” të ligjit nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 9.5.2008, i ndryshuar, dhe

2- Pikën 2, të nenit 4, të Rregullores nr.30 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, miratuar me VKD nr. 2395, datë 5.12.2013,

Procedura e aplikimit për Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave, bëhet duke plotësuar nga aplikanti/kërkuesi në Modulin e Aplikimit *Online* për Autorizim Individual, format përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen elektronike të AKEP web: [www.akep.al](http://www.akep.al) në seksionin e-Aplikime.

Përsa i përket pagesave, mbështetur në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pagesat që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave bazohen në këto akte:

- VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”,
- Udhëzim nr. 28, datë 12.1.2015 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit"”

### 13. Procedura e njoftimit për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike

Procedura për pajisjen me Certifikatë të Konfirmimit të Njoftimit (CKNJ) për ofrimin e rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, bazuar në:

- Nenin 14, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe
- Pikat 1 deri 11, të nenit 6, të Rregullores nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”,

bëhet duke plotësuar nga aplikanti/kërkuesi në Modulin e Aplikimit *Online* për Autorizim Individual, formate përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen elektronike të AKEP web: [www.akep.al](http://www.akep.al) në seksionin e-Aplikime.

Për regjistrimin si ofrues në regjistrin e ofruesve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike sipërmarrësit nuk paguajnë. (Sipërmarrësit paguajnë në AKEP një pagesë vjetore për të mbuluar kostot administrative respektive të AKEP-it për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike. Kjo pagesë nuk është me shume se 0.5 % e të ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm, të siguruara vetëm nga shërbimet elektronike.)